



BASHKIA E MIRDITË

MIRATOHET




ANDREC DEDAJ

KRYETAR

DETYRË PROJEKTIMI

HARTIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT
“RIKUALIFIKIMI I QENDRES SE QYTETIT”

SHESHI "ABAT DOCI"

Mirdite, Nentor 2015



Bashkia e Mirditës, kërkon të realizojë projektin e zbatimit të objektit: "Studim – Projektim për Rikualifikimin i Qendrës së Qytetit, Sheshi Abat Doci", në qytetin e Rreshenit me vlerë paraprake të zërit Ndërtim - Motim 224,282,212 lekë (me TVSH).

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

Ky bllok ndodhen në pjesën qendrore të qytetit të Rreshenit. Blloku që parashikohet të trajtohet në këtë detyrë projektimi kufizohet përkatesisht nga këto rrugë: Sheshi "Abat Doci", Sheshi që kufizohet nga veriu në jug nga objekte banimi dhe pjesa e rrugës "At Gjergj Fishta", në Perëndim nga segmenti i rrugës para Bashkise dhe zgjatimi i saj deri në bashkimin me rrugën "Vincenzo De Paoli", dhe nga Lindja zona e banimit.

Blloku ku do të nderhyet ka si kufizim në veri segmentin e rrugës "Vincenzo De Paoli" (shiko planimetrinë), në perëndim dhe në jug me segmentin e rrugës "para Bashkise" në Lindje rrugën "At Gjergj Fishta" dhe në jug Lulishten prapa prefektures.

Blloku në studim kanë një sipërfaqe prej 1.7 ha ku dominojnë ndërtimet para viteve 1990, 2-5 kate.

Gjëndja e infrastrukturës në këtë bllok paraqitet:

- Rrjeti rrugor

Ekzistojnë gjurmët e rrugëve kryesore dhe sekondare me dëmtime të shtresave asfaltike në pjesën e Qendrës, si dhe dëmtime të shtresave asfaltike në pjesën e bllokut. Segmenti i rrugës "At Gjergj Fishta" është aks kryesor kufizues i bllokut. Kjo rrugë është në gjendje të mirë. Aksi rrugor "Para Bashkise" është rrugë kryesore në të cilin kanë akses rrugët e brendshme të bllokut. Ky aks rrugor është në gjendje pjesërisht të mirë.

- Kanalizimet e ujërave të zeza

Egziston rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza në këtë bllok. Në këtë bllok rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza është i vjetër.

- Kanalizimet e ujërave të bardha

Ekziston rrjeti i kanalizimeve të ujërave të bardha në Bllokun, Sheshi Abat Doci. Në Pjesët lidhëse me rrugën para bashkise ky rrjet mungon.

- Rrjeti ujësjellësit

Në të dy zonat e bllokut ekziston rrjeti i ujësjellësit. Në zonën e qendrës është rrjeti i vjetër i riparuar pjesërisht. Në zonën tjetër ka rrjet të vjetër ujësjellësi.

- Rrjeti ndriçimit rrugor

Ekziston rrjeti i ndriçimit rrugor në segmentet kryesore rrugore kufizuese të bllokut. Ka mungesë të rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët e brendshme të dy blloqeve.

- Sipërfaqet e gjelbërta

Në Qendrën, Sheshi Abat Doci ka sipërfaqe të gjelbërta pas pallatit të kultures dhe pas prefektures por këto në gjendje të dëmtuar. Blloku ka mungesë të sipërfaqeve të gjelbërta. Në rrugën "At Gjergj Fishta" vihet re dëmtimi i gjelbërimit të lartë (pemeve dekorative).

Ka një sërë rrugësh egzistuese të bllokut të cilat kanë nevojë të trajtohen nga pikëpamja e ndërtimit të infrastrukturës, ndërtimit të shtresave rrugore, ku do të ndërtohen rrjeti sekondar i kanalizimeve, i ujësjellësit, ndriçimit rrugor si dhe sipërfaqeve të gjelbra, etj. Në Qendrën e qytetit katrori që aktualisht është shesh të kthehet në sipërfaqe pedonale dhe të gjelbërt, si dhe rruga "At Gjergj Fishta" të trajtohet si zone me trafik të kufizuar me orare të paracaktuara.

2. Kërkesa të veçanta

Objekt i projektit do të jetë sistemimi i bllokut të banimit, me të gjithë elementët e infrastrukturës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit të kësaj zone.

Në këtë zonë gjatë hartimit të projektit të rrugëve të kihen parasysh Studimet Urbanistike Pjesore (nëse ka), si dhe parashikimet e Planit të Ri Rregullues, Masterplani i Transportit. Gjithashtu, për të përcaktuar saktë kapacitetin për të gjitha shërbimet e kërkuara duhet patur parasysh koeficienti i dendësisë së popullsisë sipas Rregullores së Urbanistikës në fuqi ose 400 banorë/ha, si dhe duhen marrë në konsideratë zhvillimet urbane të pritshme dhe në prespektivë të zonës/bllokut në fjalë.

2.1 Rrugët

Për trajtimin e rrjetit rrugor, duhet të kihen parasysh Standartet në fuqi (Rregullorja e urbanistikës, KTP). Rrugët në brendësi të bllokut të trajtohen me gjerësi të trupit të rrugës ekzistuese me mundësi zgjerimi të tyre, në varësi të rëndësisë dhe të hapësirës. Të trajtohen troruaret ekzistuese dhe të parashikohen në projekt trotuare në vendet ku hapësirat e lejojnë një gjë të tillë.

Shtresat rrugore të trajtohen të tilla që të sigurojnë garanci për rrugën, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës.

Gjatë hartimit të projektit të shikohet mundësia e ndërtimit të parkingjeve si dhe vendet e kontenierëve në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Mirditë.

Materialet që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të rrugëve.

Në përfundim mund të thuhet se projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet që paraprakisht:

1. Të bëjë relievin (azhornimin) e sipërfaqes së bllokut ku do të ndërhyet; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
2. Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës, etj, sipas Formularit 3/1;
3. Projektuesi duhet të bëjë verifikimi paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/axhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës, përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra që nuk përputhen me gjendjen në terren;
4. Të bëjë studimet përkatëse gjeologjike, hidrologjike etj (sipas kërkesave të projektimit dhe Formularit 3/1).

• Skema e rrjetit rrugor

Në bazë të sa më sipër, kërkohet që Projektuesi të organizojë punën e tij projektuese në disa faza.



Mbasi përfundojnë azhurnimet në terren, verifikimet si dhe studimet e nevojshme, për të gjithë bllokun, projektuesi bën një analizë të shkurtër të situatës dhe konsultohet me Bashkinë (Drejtoria e Planifikimit Urban), ku merr edhe të dhënat e para mbi ecurinë e planeve/studimeve dhe ndikimin e tyre në projektin e tij.

Projektuesi harton paraprakisht:

- **Skemën e rrjetit rrugor**

Hartimi i skemës shoqërohet me:

- a. relacion teknik;
- b. një analizë të situatës ekzistuese, në raport me efektet sociale që mund të sjellë projekti në drejtim të prishjes së ndërtimeve dhe të elementeve të kosto-efektivitetit dhe të impaktit social, ekonomik, funksional dhe mjedisor të ndërhyrjes, duke përcaktuar të gjitha prishjet, statusin e godinës, pozicionin e tyre, kostot e pritshme për Bashkinë për shkak të prishjeve, sipërfaqen dhe vlerën e përafërt të objekteve që prishen, si pjesë e analizës së efekteve të pritshme. Objektet që prishen do të identifikohen me vendodhjen në gjatësi lineare të rrugës, ose në hapësirën midis bllokut (të shoqërura këto me shkakun e prishjes dhe llojin e prishjes, pjesërisht, terësisht etj), si dhe me të dhëna individuale për çdo godinë. Prishjet duhet të konceptohen që të minimizojnë efektet negative për Bashkinë ose të rrisin kostot.

Qëllimi i kësaj faze është që Projekti të ketë analizë të përputhshmëris me planet, eficient ekonomik të ndërhyrjes, pra efektivitet të koston, minimizim të impakteve negative sociale (si p.sh të prishjeve të panevojshme për këtë fazë, etj).

- **Skemën e qarkullimit/lëvizjes**

Projektuesi duhet të hartojë dhe të paraqesë paraprakisht, së bashku me skemën e rrjetit rrugor edhe analizën dhe skemën e qarkullimit/lëvizjes në bllokun e banimit. Kjo skemë duhet të jetë Fletë e veçantë e projektit.

Projekti/skema duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë:

- Aksesibilitetin për të gjitha kategoritë e mjeteve, duke përfshirë rastet dhe mjetet e emergjencës (sidomos ato të zjarrit, shendetit etj);
- Parashikimin e mënyrës së lidhjes së bllokut me akset kryesore dhe blloqet e tjera të banimit kufitarë;
- Aksesibilitetin e këmbësorëve duke i dhënë një përparësi të qartë në rezervimin e hapësirës pedonale të lëvizjes si dhe duke parashikuar lidhjen e lëvizshmërisë së tyre në zonë;
- Aksesibilitetin e biçikletave dhe rezervimin e sipërfaqeve brënda bllokut për parkimin e tyre;
- Nëse blloku i banimit ka lidhje me akse kryesore lëvizje që kanë rrjete të transportit publik, duhet të analizohet dhe parashikohet mënyra e ndërlidhjes së akseve dytësore/tretësorë me atë parësore dhe lehtësinë në lëvizjen e qytetarëve;
- Aksesibiliteti i personave me aftësi të kufizuara;
- Shfrytëzimin efektiv të rrugës për parkimin e rezidentëve etj dhe sidomos parashikimi i vendeve për personat me aftësi të kufizuara;

- Të gjithë elementët e mësipërm të ndërthuren në një projekt sinjalizimi rrugor duke i dhënë përparësi lëvizjes me një drejtim, në përputhje me projektet e Bashkisë si dhe duke siguruar një organizim të lëvizjes që përmbush kërkesat si të banorëve ashtu dhe të aktiviteteve të mundshme ekonomike të zonës;
- Plotësimin e elementëve të sigurisë rrugore duke trajtuar me kujdes të gjithë elementët (kalimet këmbësore, këndet e shikimit, ndriçimi, etj.).

Të trajtohet në projekt mënyra e lëvizjes si dhe masat e sigurisë së këmbësoreve gjatë punës për realizimin e objektit në të gjitha fazat. Projektuesi duhet të paraqesi në flete të veçanta të gjitha detajet e nevojshme të masave të sigurisë që do të reflektohen edhe në preventiv. Skema e rrjetit rrugor+plani i propozuar i ndërhyrjes për lirim të sheshit të ndërtimit (prishjet) do të diskutohen me Bashkinë dhe mbasi të marre miratimin e saj, Projektuesi vazhdon me detajimin në projekt-zbatimin të bllokut.

2.2 Ndriçimi rrugor

Në rrugët kufizuese të zonës ku ndriçimi rrugor është bërë i ri, të lihet ai ekzistues, kurse për rrugët e tjera të bëhet i ri.

Në rrugë me gjerësi deri në 7.2 m të parashikohet vendosja në të dy krahet e rruges në menyre të shkallëzuar e shtyllave të reja metalike me lartësi $H=7.8m$ deri 9m dhe me spesor $\delta=4mm$, ndërsa për rrugë me gjerësi mbi 9 m, vendosja e shtyllave të reja metalike me lartësi $H=8.8m$ dhe me spesor $\delta=4mm$, të bëhet në të dy anët e rrugës.

Kokat e ndriçuesave do jenë me gradë të lartë rezistence dhe me reflektor alumini me luçidim të lartë i paoksidueshëm, i cili bën në një masë shumë të lartë pasqyrimin e dritës. Hapja dhe mbyllja e xhamit të ndriçuesit lejon një çmontim të shpejtë gjatë mirëmbajtjes. Llampat e ndriçimit do të jenë me ngjyrë të verdhë me fuqi 150 W deri 250 W.

Linja të jetë me trase nëntokësore ku të vendoset tub plastik fleksibël me dy shtresa me $\varnothing=90$ mm për kalimin e kabllit të furnizimit dhe tub metalik me $\varnothing=100$ mm për intersektim rruge.

Pusetat të jenë prej betoni me përmasa brenda përbrenda 40x40x40cm me kapak gize. Distanca ndërmjet pusetave të jetë 25 m larg njëra tjetrës dhe të vendosen mbrapa çdo shtylle për tu mbrojtur nga dëmtimet e makinave. Panelet e komandimit të vendosen me komandim sauteri me fotoelementë.

Të parashikohet dalje energjie në puseta të veçanta për zonat e gjelbëra.

Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat egzistuese të zonës. Në këto kabina do të instalohen panelet e ndriçimit rrugor të cilat do ushqehen me ura të veçanta nga transformatori egzistues. Në kabinë do parashikohet dhe vendosja e matësve të energjisë. Do të parashikohet tokëzimi i shtyllave të ndriçimit.

2.3 Kanalizimet e ujrave të zeza

Qyteti i Rreshenit kohët e fundit ka pësuar ndryshime të dukshme në drejtim të shtrirjes së ndërtimeve duke ndjekur dy drejtime kryesore të cilat, në funksion të zhvillimit të tyre kanë sjellë probleme në rrjetin e kanalizimeve. Si drejtim i parë është rritja e intensitetit të ndërtimeve në zonat ekzistuese të ndërtimit dhe drejtimi i dytë është zhvillimi i ndërtimeve në zona pothuaj të pa zhvilluara më parë. Të dy rastet sjellin si rezultat rritjen e sasive të ujrave



të zeza dhe ujrave të shiut respektivisht për shkak të rritjes së konsumit të ujit në zonë dhe rritjes së rrjedhës së ujrave të shiut.

Ky bllok, shtrihet në një zonë me rritje të intesitetit të ndërtimeve dhe ka nevojë për rritjen e kapacitetit të rrjetit të KUZ.

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të kihet parasysh:

- Të merret në konsideratë perespektiva 20 vjeçare e rritjes së popullsisë.
- Të kihet në konsideratë ruajtja e rrjetit ekzistues që ka kapacitetin e mjaftueshëm përcjellës dhe është në gjendje të mirë punë. Informacion më i detajuar duhet të merret pranë Sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Mirditë.
- Drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës do të merret në Bashki.
- Të kihet parasysh "Studimi i Planit të zhvillimit të sistemit të kanalizimeve" kryer nga Bashkia dhe studimet pjesore të miratuara në zonën në fjalë.

Nëse është e mundur sistemi i largimit të ujrave të bardha dhe të zeza të jetë i ndarë, në te kundert të ruhet sistemi miks.

Sasite e ujit që derdhen në sistemin e kanalizimeve, Për sasitë e ujrave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve do të përdoren të dhënat e rekomanduara në studimin për kanalizimet e qytetit Rreshen si më poshtë:

$Q_{mes\ dit} = 194\ l/ditë/banore$

$Q_{max\ or} = 437\ l/ditë/banore$

Për sasitë e ujrave të shiut do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik dhe mënyra e llogaritjes do të paraqitet nga projektuesi në mënyrë të argumentuar.

Siguria Llogaritëse, Siguria llogaritëse e ujrave të shiut do të llogaritet 25 % për kolektorët kryesore dhe 40 % për kolektorët sekondarë.

Vlera e llogaritjes së shiut të merret për periudhë përsëritje 1 herë në vit dhe kohëzgjatje prej 15 minutash. Intensiteti për Rreshenit është 150-170litra/sek/ha e cila del me llogaritje.

Materiali kryesor ndërtimor, për kanalizimin do të jetë përdorimi i tubave prej polietileni të brinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat ose tubacione betoni me gota, pusetat dhe nënobjektet e tjera do të jenë me material betoni të armuar duke eliminuar përdorimin e materialit të tullës në sistemin e kanalizimeve që ka rezultuar me probleme. Megjithatë projektuesi do të argumentojë materialet që do të përdoren për çdo nën objekt. Pusetat duhet të jenë të pajisura me shkallë metalike.

2.4 Ujësjellësi

Në bashkëpunim me Ujësjellës-Kanalizime sh.a. do të saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit egzistues, projektet që ka kjo ndërmarje, si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë me rrjetin egzistues të ujësjellësit. Norma e furnizimit do të jetë 150 l/ditë/banor. Materialet që do përdoren për tubacionet e ujësjellësit do jenë tuba polietileni HDPE-100 për 10 atm që plotësojnë normativat në fuqi, kanë përbërjen kimike dhe aftësinë mbajtëse ndaj presioneve të llogaritura. E njëjta gjë vlen dhe për pajisjet hidraulike dhe aksesorët.

Saraçineskat dhe pajisjet e tjera hidraulike që do të përdoren duhet të jenë $P_n=16$ atm. Për nyjet do të parashikohen puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Pusetat duhet të jenë të pajisura me shkallë metalike në rastet kur janë të thella.

Për lidhjet e banesave me tubacione me diametër më të vogël se 2" të përdoren puseta komandimi me aks vertikal.

2.5 Elementet urban

Projekti i zbatimit për bllokun, do të përfshijë trajtimin e të gjithë hapësirës urbane brenda sipërfaqes së bllokut. Për këtë, krahas trajtimit që projektuesi i bën infrastrukturës rrugore të bllokut (skemës së rrjetit rrugor, me të gjithë elementët e tij të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore) Projektuesi do të trajtojë edhe të gjithë hapësirën urbane të bllokut me ndërhyrje të rehabilitimit dhe rikualifikimit urban. Kështu, në mënyrë më të detajuar, projektuesi do të trajtojë në fazën e projekt zbatimit, përveç infrastrukturës në rrjetin rrugor edhe:

• Hapësira Urbane

Përveç skemës së rrjetit rrugor (projektit të rrugës dhe trotuareve), Projektuesi duhet të trajtojë me projekt zbatimi, *të gjitha hapësirat e lira urbane që krijohen/mbeten nga bordura e trotuarit deri në kufirin e ndërtimeve*, godinave përgjate rrugëve ose në brendësi të blloqeve (pra deri në rrezen e objekteve përgjate rrugës dhe në brendësi të bllokut); trajtimi i tyre të bëhet me elemente të rikualifikimit urban (shtrim, etj), përveç elementëve të gjelbërimit të lartë apo të ulët sipas rastit dhe specifikave të vendndodhjes.

Do të jenë Fletë të veçanta të projektit, trajtimi dhe detajimi teknik (faza/projekt zbatim) për secilin prej këtyre elementëve të hapësirës urbane.

Përveç sa më sipër, Projektuesi duhet të identifikojë në terren të gjitha hapësirat e tjera urbane, të lira ose që lirohen nga Projekti, të cilat janë të përshtatshme të planifikohen për ndërhyrje të rikualifikimit urban, të tilla që krijojnë sheshe të vogla brenda bllokut të banimit, ku mund të akomodohen funksione të tilla si ambiente shpłodhëse (me stola etj) për moshën e tretë dhe banorët e qytetit, sipërfaqe të gjelbërta, kënde të vogla për fëmijë, etj.

Për hapësirat e identikuara si të tilla (si në rastet kur kërkojnë prishje të ndërtimeve pa leje ekzistuese dhe në rastet kur janë të lira), Projektuesi do të hartojë paraprakisht një skemë të shpërndarjes së këtyre hapësirave në territor, si dhe të projekt-idese së tij për zgjidhjen funksionale të tyre dhe projekt-idene teknike. Pasi ta ketë diskutuar dhe marrë miratimin paraprak të Bashkisë, do të harroje për to projektin e plote teknik dhe të zbatimit.

Projektuesi do të paraqesë secilen nga këto hapësira si një nenprojekt (me të gjitha detajet teknike dhe fletët, si të ishte një projekt-zbatim i veçantë, përfshirë edhe preventivin).

Në trajtimin e hapësirës, përjashtohen objektet sociale.

Projektuesi do të japë zgjidhje dhe për vaditjen e sipërfaqeve të gjelbërta të bllokut, sigurimin e burimit të ujit. Kjo e shoqëruar me projektin dhe preventivin përkatës.

• Elementet e mobilimit urban

Një vëmendje të veçantë në projekt, Projektuesi duhet t'i kushtojë edhe elementëve të mobilimit urban (ose kur është rasti edhe të artit urban) që do të propozojë të përdoren në të

gjithë bllokun e banimit, si përgjatë rrugëve ashtu edhe në hapësirat urbane të përshkruara më lart, të tilla si: stola, kosha të mbeturinave, vendin e vendosjes së konteinerëve dhe të largimit publik të mbeturinave (përcaktimi i tyre të bëhet në bashkëpunim me Drejtorin e Pastrimit në Bashki), zgara apo rrethime të pemëve, kangiella kufizuese në trotuare (kur është rasti) si dhe bllokues të mjeteve në trotuare, zgarat për bicikletat, etj.

Projektuesi duhet të trajtojë këto elementë në fazën e projektit të zbatimit (me të dhëna të plota për furnizim-vendosje), ku të përcaktojë detaje tip, frekuencën e vendosjes, pra skemën e shpërndarjes së tyre në të gjithë territorin e bllokut, llojin e materialit, detaje të inkastrimit, ngjyrat, sasinë, zerin në preventivë, etj.

2.6 Rrjeti Internet-Telefonisë

Të ndërtohet rrjeti i tubacioneve shpërndarëse të internet – telefonisë, sipas standarteve të përcaktuara duke marrë në konsideratë numrin e operatorëve operues në zonë, numrin e komunitetit përftues, si dhe zhvillimin në prespektivë të këtij shërbimi, për një periudhë kohore 10 vjeçare. Kjo të realizohet nepermjet linjave rezerve.

Ky rrjet duhet të shtrihet në të gjithë akset rrugore kryesore dhe sekondare si dhe të ketë ndërlidhje me rrjetin ekzistues në zonat kufizuese rreth bllokut (ajror ose nëntokësore).

3. Fazat e zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të prishjeve (të mundshme) si dhe të efikasitetit të ndërhyrjes në këtë bllok, Projektuesi duhet t'i rekomandojë Investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve të ndryshëm) të Projektit.

Pra Projektuesi mund t'i rekomandojë Investitorit që projekti të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij (psh. rrjetit rrugor dhe infrastruktura/punime ndërtimi, apo mobilimi urban/furnizim, vendosje).

Për këtë Projektuesi do të propozojë fazat e realizimit të projektit, ku të dhenat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë duhet të jenë të konceptuara ose organizuara që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit (buxhetim, prokurim, kontraktim për zbatim) të projektit me faza.

4. Hartimi i Preventivit

Në hartimin e preventivit, vec të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizimin e zbatimit me faza, çmimet e referencës do të jepen nga Bashkia (Drejtoria e Planifikimit Urban/Spektori i Projektimit dhe Standartizimit), sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të paraqitet sipas Formatit/Modelit të rekomanduar nga Bashkia.

5. Standartet

- **Standarte në Projektim**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi.

Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjate zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuar, të verberit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastruktures për këte kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

- **Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik**

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

6. Realizimi i Projektit

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit i “Rikualifikimin i Qendrës së Qytetit, i cili duhet të përmbajë:

1. Raportin Teknik
2. Hartimi i relievit topografik të bllokut (kordinata lokale, kuota absolute)
3. Skemën e rrjetit rrugor, analizën dhe skemën e qarkullimit/lëvizjes në bllokun e banimit.
4. Projektin e zbatimit të traseve të rrugëve.
5. Kuotat e pusetave ekzistuese (koka e tubit, diametri i tubit)
6. Profilin gjatësor të rrugëve.
7. Profilat tërthorë të rrugëve
8. Profilat tip të seksionit tërthor të rrugës
9. Detajet e ndryshme të trotuarit, bordurave etj
10. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut.
11. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza.



12. Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve etj.
13. Projektin e sistemit të ndricimit pedonal dhe rrugor.
14. Sinjalizimin vertikal dhe horizontal.
15. Projektin e gjelbërimit të rrugës.
16. Projektin e Hapësirave dhe të Mobilimit urban.
17. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
18. Grafikon e punimeve.
19. Vleresim të Ndikimit në Mjedis.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin egzistues lidhur me bllokun ku do të ndërhyet.
- Projektuesi duhet të hartojë përveç projektit përfundimtar dhe nje projekt teknik, i cili duhet të analizojë rast pas rasti të gjitha prishjet e mundëshme për të realizuar me faza këte investim.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Mirditës, seksioni i Urbanistikës dhe nga Kadastra. Në hartimin e projektit duhet të kihet parasysh edhe standarte të ndryshme që ka nxjerrë Bashkia e Mirditës siç janë p.sh. tipi i kollonave të ndriçimit, llojet e ndriçuesve e të tjera të kësaj natyre.
- Grupi i projektimit përveç rrjetit rrugor dhe të infrastrukturës nëntokësore, duhet të trajtojë dhe hapsirat e brendëshme të bllokut, si zonat e gjelbërta, terrenet shplohese, këndet për fëmijë, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar.

Projektuesi duhet të ketë parasysh dhe të trajtojë:

- Sistemin egzistues të largimit të ujrave
- Sistemin e furnizimit me ujë të zonës (nqs ka)
- Sistemin e ndriçimit rrugor
- Gjelbërimin dhe mobilimin urban
- Punimet provizore.


Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Mirditës. Stafi që kërkohet duhet të mbulojë :

- Inxhinier hidroteknik
- Inxhinier ndërtimi
- Inxhinier topograf
- Inxhinier mjedisi
- Arkitekt
- Staf mbështetes për fushat e mësipërme.

Raportimi

- I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje origjinale, në version të dixhitalizuar dhe në 3 (tre) CD.
- Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi.



Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Llogaritjet statike të strukturave.
- Raportin teknik, ku përveç llogaritjeve të sipërpërmendura, do të jepen llogaritjet e shtresave, të dhëna të sakta, bazuar në teste për gjendjen egzistuese, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, raporti gjeologjik, siguria e kalimit në rrugë dhe masat që duhet të merren për rregullimin e trafikut gjatë punimeve të ndërtimit, Specifikimet Teknike për ç'do zë pune.
- Metoda e llogaritjes së shtresave të jetë e bazuar në CBR.
- Preventivi i plotë i kushtimit të veprës me çmimet e dhëna nga Bashkia e Mirditës.

Raporti gjeologjik dhe vetite fiziko-mekanike të dherave

Në raportin gjeologjik duhet të paraqiten:

- Cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në trupin e rrugës.
- Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.

Hidrologjia

Të bëhet studimi hidrollogjik për të përcaktuar hidromodulin e zonës në studim

Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimum fletët si më poshtë:

1. Topografinë e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje) ne Shk. 1:500 ose 1:1000
2. Planimetria e sistemimit të bllokut ne Shk. 1:500 ose 1:1000
3. Planimetria e prishjeve të bllokut (nqs ka) ne shkalle 1:500
4. Planimetria e prishjeve të bllokut faza pare (nqs ka) ne shkalle 1:500
5. Profilat gjatesorë të rrugëve Shk. 1:1000, 1:100.
6. Profilat tërthorë të rrugëve jo më pak se 25 m
7. Detaje konstruktive tip të shtresave të rrugës, trotuareve, pusetave, etj.
8. Kryqëzimet dhe detaje përkatëse.
9. Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën 1: 500
10. Profilat gjatesorë të rrjetit të kanalizimeve në Shk. H1:1000, V1:100
11. Puseta dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve
12. Planimetria e rrjetit të ujesjellësit në shkallën 1: 500
13. Profilat gjatesorë të rrjetit të ujesjellësit në Shk. H1:1000, V1:100
14. Pusetat, detajet e nyjeve dhe lidhjeve si dhe detaje të tjera të rrjetit të ujesjellësit.
15. Planimetri dhe detaje për levizshmeri/sinjalistikën rrugore.
16. Planimetria e hapësirave publike dhe mobilimit urban.
17. Detaje teknike të mobilimit urban.
18. Planimetria e ndriçimit rrugor dhe detaje të ndriçimit rrugor.
19. Planimetria e tubacioneve të rrjetit të internet telefonise ne shkalle 1:500
20. Profilet gjatësore të rrjetit të internet telefonisë (linja rezerve) në Sh: H 1:1000, V 1:500



7. Investimi Themelor

Investimi themelor do të dal nga varianti më i mirë i aprovuar nga Urbaniste dhe Inxhinierë të Bashkisë së Mirditës.

8. Sqarime të fundit

Të dhënat e nevojshme për projektim, siç janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, vendosja e kontenierëve, planin rregullues të zonës etj. do t'i bashkangjiten kësaj detyre.

PERGJEGJESI I URBANISTIKES

Ing. Altin MARASHI